

Emri i Lëndës : Konceptim dhe Menaxhim Fushatash							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 523	C	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Valmora Gogo, PhD					
Asistenti		Edlira Mali, MSc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Lënda synon të jap njohuri të detajuara mbi organizimin dhe menazhimin e fushatave zgjedhore. Puna dhe procesi mësimor në këtë lëndë do të zhvillohet në shkëmbim eksperiencash midis lektorit dhe studentëve. Një rëndësi e veçantë do t'u kushtohet projekteve që studentët do të punojnë në mënyrë individuale apo në grup. Pjesëmarrësit e kursit do të ndërtojnë portofolet individuale të komponentëve të fushatës zgjedhore, të tilla si deklaratat e kandidatit, si dhe të kontribuojnë në dallimet ndër-juridiksionale në mënyrë krahasuese të projektit të menaxhimit të fushatës zgjedhore.					
Objektivat		Objektivat e kësaj lënde synojnë: 1. Zhvillimin dhe kuptimin e një ndarje të duhur të punës në mes pjesëmarrësve të grupit. 2. Duke pasur parasysh të dhënat e target audiencës, të zhvillojnë mesazhe efektive të fushatës dhe të përcaktojnë një angazhim të llojeve të ndryshme medias për të promovuar dhe mbështetur fushatën me qëllim influencimin dhe bindjen e audiencës për të përkrahur dhe mbështetur fushatën. 3. Përdorimi i të dhënave të audiencës për të zhvilluar një buxhet të përshtatshëm (dhe me kosto të ulët) fushate, duke përfshirë edhe planet realiste për ngritjen e fondeve. 4. Hartimi i një plani për shfrytëzimin maksimal të vullnetarëve/ambasadorëve si përçues të mesazhit të fushatës tek audienca e synuar. 5. Krijimi i një analizë krahasuese për drejtimin e fushatës në juridiksione të ndryshme lokale (në një sërë vendesh në varësi të pjesëmarrësve)					
Konceptet Kryesore		1. Fushata sensibilizuese 2. Fushata elektorale, 3. Brainstorming 4. Buxhetimi 5. Sigurimi i fondeve, donacioneve 6. Ambasadorët 7. Menaxhimi i Fushatës 8. Studimi i tregut 9. Mesazhet e fushatës 10. Komunikimi i integruar 11. Marrëdhëniet publike 12. Objektivat e fushatës 13. Planifikimi i fushatës 14. Plan i veprimeve 15. Analiza 16. Feedback ...etj.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Kuptimi i problematikës. Bazat dhe elementët kryesorë të një fushate. Llojet e ndryshme të fushatave.						
2	Brainstorming, diskutime, debitime për konceptimin e fushatës – projekt semestral. Planifikimi i elementeve të ndryshme të fushatës. Elementët e ndryshëm të fushatës, grupi i punës ndarja e detyrave.						
3	Kandidati dhe vlerësimi i oponencës						
4	Hapja zyrtare e fushatës projekt semestral – përzgjedhja dhe instruktimi i ambasadorëve.						
5	Plani i Fushatës. Rregullat kyçe të Fushatës Elementët e një plani efektiv						
6	Targetimi i audiencës / votuesve						
7	Zhvillimi i Mesazhit të Fushatës						
8	Provim Gjysmëfinal						
9	Sondazhet Politike dhe Raportet Strategjike.						
10	Planifikim i avancuar: Përgatitja e buxhetit dhe mënyrat e mbledhjes së fondeve						

11	Planifikim i avancuar: Kontakti me audiencën dhe ndikimi mediatik. Propagandimi dhe bindja e audiencës.
12	Fushata online – Roli dhe mënyrat e përdorimit të internetit gjatë fushatës. Deklaratat e kandidatit, e-mailet e drejtpërdrejta dhe telefoni.
13	Menaxhimi i fushatës; Kandidati, menaxheri, stafi dhe vullnetarët.
14	Menaxhimi i fushatave sipas juridiksioneve të ndryshme. Analiza e fushatës - projekt semestral.
15	Prezantim i projekteve të studentëve
16	Provim Final
Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Political Campaign Planning Manual. A step by step guide to winning elections, National Democratic Institute for International Affairs • Dennis W. Johnson, No Place for Amateurs;
Referenca të tjera	• Robert Greene, 33 Stratagems of War • Richard Semiatin, Campaigns on the Cutting Edge • John Sides, Daron Shaw, Matthew Grossman, and Keena Lipsitz, Campaigns and Elections: Rules, Reality, Strategy, Choice (New York: W.W. Norton, 2011)
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të kuptojnë elementët e konceptimit të një fushate, duke përfshirë edhe fushatën zgjedhore.
2	Studentët krijojnë një ide më të qartë rreth përdorimit të mjeteve të ndryshme demokratike për menaxhimin e një fushate.
3	Studentët do të jenë në gjendje të hartojnë një buxhet për fushatën dhe të realizojnë ngritjen e fondeve të nevojshme për realizimin e fushatës.
4	Studentët do të jenë të aftë të konceptojnë dhe menaxhojnë një fushatë të mirëfilltë.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	1	20	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	20	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			70
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			30
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	1	10	10
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	10	10
Të tjera	1	2	2
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00